

VENDIM
Nr. 513, datë 18.9.2021

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në pikën 1/2, pas fjalëve “... Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ...” shtohet emërtesa “Agjencia për Media dhe Informim”.

b) Pas pikës 8/12 shtohet pika 8/13, me këtë përmbajtje:

“8/13. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”, “Zëdhënës i ministrit”, “Koordinator”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Agjencinë për Media dhe Informim, janë sipas lidhjes nr. 5/13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2021, të përballohen nga fondet e miratuara për këtë institucion dhe fillojnë nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 5/13

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm”, “Zëdhënës i ministrit”, “Koordinator”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në Agjencinë për Media dhe Informim

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Zëvendës drejtor i Përgjithshëm	I-b	1
Zëdhënës i ministrit Koordinator Drejtor drejtorie	II-b	1

Pērgjēgēs sektori	III-a	1
	III-a/1	1
Specialist	III-b	1 ose 2
	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3